

Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, në bashkëpunim me Njësinë Bazë të Infermierisë, zhvilloi një aktivitet sensibilizues dhe informues me studentët, në kuadër të Ditës Botërore të Shëndetit Mendor.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte rritja e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e shëndetit mendor, nxitjen e kujdesit ndaj mirëqënies psikologjike dhe promovimin e një mjedisi të shëndetshëm emocional për studentët.

Aktiviteti u zhvillua në një atmosferë të hapur diskutimi mbi sfidat që ndikojnë në shëndetin mendor, mënyrat e përballimit të stresit, si dhe rëndësinë e kërimit të ndihmës profesionale në kohë. Gjithashtu u theksua roli që luan shëndeti mendor në suksesin personal dhe profesional të individit.

Pjesëmarrës në aktivitet ishin studentë të degëve të ndryshme.

